



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024  
ME ZGJEDHJE – SESIONI I  
SKEMA E VLERËSIMIT

Lënda: Gjeografi

VARIANTI A

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	A	D	A	B	A	C	D	A	B
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Përgjigja e saktë	C	C	A	B	C	C	D	D	D	D

Pyetjet me zhvillim

*Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.*

Pyetja 21

Model përgjigjeje

a) 1 pikë

- Hartë topografike

**1 pikë** Nëse gjen saktë llojin e hartës.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

b) 1 pikë

- Relievin

**1 pikë** Nëse gjen elementin e sipërfaqes së tokës që paraqet harta e dhënë.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

c) 1 pikë

- 1440m

**1 pikë** Nëse gjen saktë vlerën e izolinjës (izohipsit) në pikën I.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 22****Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

- Figura 2

**1 pikë** Nëse tregon saktë qendrën barike me trysni atmosferike të ulët.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**b) 2 pikë**

- Trysnia atmosferike rritet nga qendra në drejtim të periferisë;
- Ajri lëviz nga periferia drejt qendrës;
- Ajri kryen lëvizje ngjitëse;
- Ajri zhvendoset nga poshtë-lart;
- Sjell mot me reshje;
- Etj

**2 pikë** Nëse shkruan dy nga tiparet e qendrës barike.

**1 pikë** Nëse shkruan një nga tiparet e qendrës barike.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 23****3 pikë****Model përgjigjeje**

- Ndryshim: Liqenet tektonike formohen nga mbushja me ujë e fundosjeve tektonike, ndërsa ato karstike nga mbushja me ujë e gropave karstike.
- Ndryshim: Liqenet tektonike janë liqene shumë të mëdhenj, ndërsa ato karstike janë të vegjël.
- Ndryshim: Liqenet tektonike janë liqene shumë të thellë, ndërsa ato karstike janë të cekët.
- Ndryshim: Liqenet tektonike kanë brigje të larta, gati vijëdrejta, pak të thyera, ndërsa ato karstike dallohen për formën rrethore dhe lakueshmëri të madhe të vijës bregliqenore.
- Etj

**3 pikë** Nëse identifikon tre ndryshimet midis tyre.

**2 pikë** Nëse identifikon dy nga ndryshimet midis tyre.

**1 pikë** Nëse identifikon një nga ndryshimet midis tyre.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 24****Model përgjigjeje****a) 2 pikë**

- Shkëmbinj magmatikë intruziv të cilët formohen kur magma mbetet në brendësi të kores tokësore dhe ngurtësohet në thellësi. Ngurtësimi i saj bëhet ngadalë në temperatura të larta.
- Shkëmbinj magmatikë efuziv të cilët formohen kur magma ngurtësohet pasi del në sipërfaqe. Ngurtësimi i llavës bëhet më shpejt dhe në temperatura më të ulta.

**2 pikë** Nëse shpjegon dy llojet e shkëmbinjve magmatikë në varësi të vendit të ngurtësimit të magmës.

**1 pikë** Nëse shpjegon një nga llojet e shkëmbinjve magmatikë në varësi të vendit të ngurtësimit të magmës.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b) 1 pikë**

- shkëmbinj magmatikë acidë,  
OSE
- shkëmbinj magmatikë mesatarë,  
OSE
- shkëmbinj magmatikë bazikë,  
OSE
- shkëmbinj magmatikë ultrabazikë.

**1 pikë** Nëse emërton një prej tyre.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 25****Model përgjigjeje****a) 2 pikë**

Tjetërsimi fizik për shkak të ngricave ndodh kur temperaturat janë rreth 00C, kur shkëmbinjtë janë të çarë e të plasaritur dhe kur këto të çara e të plasaritura mbushen me ujë. Kur temperatura ulet nën 00C, uji në të çarat e shkëmbit ngrin. Akulli i formuar duke rritur vëllimin ushtron trysni mbi të çarat e shkëmbinjve. Shkëmbinjtë shkatërrohen, copëtohen dhe thërrmohen.

**2 pikë**

Nëse shpjegon saktë se si ndodh tjetërsimi fizik për shkak të ngricave.

**1 pikë**

Nëse shpjegon pjesërisht se si ndodh tjetërsimi fizik për shkak të ngricave.

**0 pikë**Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**b)****1 pikë**

- Ky lloj tjetërsimi mbizotëron më tepër në zonat e ftohta.

**1 pikë**

Nëse gjen saktë zonat ku mbizotëron më tepër ky lloj tjetërsimi.

**0 pikë**Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 26****3 pikë****Model përgjigjeje**

- *Gjerësia gjeografike.* Në gjerësi të mëdha gjeografike klima është më e ashpër sesa në gjerësi më të vogla gjeografike. Me shtrirje kryesisht në gjerësitë mesatare Evropa dallohet përgjithësisht për një klimë të butë.
- *Pozita gjeografike.* Dalja e gjerë në Oqeanin Atlantik ka bërë që klima të ketë tipare oqeanike në Evropën Perëndimore dhe Veriperëndimore ndërsa në jug Deti Mesdhe i jep karakter mesdhetar klimës subtropikale të Evropës.
- *Masat ajrore dhe rrymat detare.* Në varësi të specifikave të tyre, masat ajrore dhe rrymat oqeanike e bëjnë klimën më të ngrohtë ose më të ftohtë. Masat ajrore që fryjnë nga pjesa veriore dhe lindore drejt Evropës janë të thata dhe të ftohta ndërsa ato që vijnë nga Atlantiku janë përgjithësisht të ngrohta dhe me lagështirë.
- *Copëtimi i theksuar i vijës bregdetare.* Ky copëtim i jep klimës tipare detare.
- Etj.

**3 pikë**

Nëse shpjegon tre nga faktorët.

**2 pikë**

Nëse shpjegon dy nga faktorët.

**1 pikë**

Nëse shpjegon një nga faktorët.

**0 pikë**Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**Pyetja 27****Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

- Ka një vijë bregdetare shumë të thyer, duke formuar fjarde.

**1 pikë**

Nëse evidenton karakteristikën dalluese të vijës bregdetare të Evropës Veriore.

**0 pikë**Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.**b)****1 pikë**

- Hidrografia është shumë e pasur. Ajo dallohet për lumenj të shkurtër me ujë të bollshëm dhe për numrin e madh të liqeneve akullnajore.

**1 pikë**

Nëse paraqet saktë tiparet e hidrografisë së Evropës Veriore.

**0 pikë**Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**c) 1 pikë**

- Ka male të vjetra, Skandinave.
- Pjesa jugore e gadishullit Skandinav ka reliev fushor.
- Në Finlandë gjendet një ultësirë me lartësi 200-300m.
- Gadishulli i Jutlandës dallohet për relievin fushor e tërësisht të sheshtë.
- Një pjesë e territorit është nën nivelin e detit.
- Islanda ka reliev kryesisht malor.
- Etj.

**1 pikë** Nëse jep një nga karakteristikat e relievit të Evropës Veriore.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 28 3 pikë****Model përgjigjeje**

- Qytetërimi maja – Amerikë Qendrore (Meksikë).
- Qytetërimi actek – Amerikë Qendrore (Meksikë).
- Qytetërimi inkas – Amerikë Jugore (Peru).

**3 pikë** Nëse përcakton tre nga qytetërimet e hershme duke specifikuar edhe vendndodhjen e tyre.

**2 pikë** Nëse përcakton dy nga qytetërimet e hershme duke specifikuar edhe vendndodhjen e tyre.

**1 pikë** Nëse përcakton një nga qytetërimet e hershme duke specifikuar edhe vendndodhjen e tyre.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 29****Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

- Pjesa më e madhe e shteteve të këtij rajoni dallohet për shkallë të lartë urbanizimi si p.sh.Tajvani, Japonia, Koreja e Jugut, Kina.

**1 pikë** Nëse evidenton një veçori të urbanizimit të rajonit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b) 2 pikë**

- *Ndryshimi:* Koreja e Jugut dallohet për një shkallë të lartë urbanizimi, ndërsa Koreja e Veriut për një shkallë të ulët urbanizimi.
- *Argumenti:* Ky ndryshim lidhet me sistemet e ndryshme politike midis këtyre dy vendeve.

**2 pikë** Nëse identifikon një ndryshim në drejtim të urbanizimit midis Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut përmes një argumenti që mbështet përgjigjen.

**1 pikë** Nëse identifikon një ndryshim në drejtim të urbanizimit midis Koresë së Veriut dhe Koresë së Jugut pa argumentuar përgjigjen.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 30****Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

- Emetimi i gazeve serrë nga makinat,
- industrinë,
- shpyllëzimet,
- djegia e lëndëve fosile,
- Etj.

**1 pikë** Nëse identifikon një nga shkaqet e ndryshimeve klimatike.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b) 3 pikë***Natyrore:*

- Rritja e temperaturës,
- Krijimi i thatësirave,
- Stuhitë e shumta,
- Përmytjet,
- Rritja e temperaturës së oqeanëve,
- Shkrija e akullnajave,
- Rritja e nivelit të detit.
- Ishuj dhe qytete që humbasin.

*Ekonomike:*

- Dëmtim i tokave bujqësore,
- Probleme në sigurimin e ushqimeve,
- Pakësimi i lëndëve djegëse fosile.
- Etj.

*Sociale:*

- Ndryshimi i cilësisë së jetës së njerëzve,
- Përkeqësim i shëndetit të njerëzve,
- Emigrimet mjedisore,
- Luftërat mjedisore,
- Etj.

- 3 pikë** Nëse përcakton një nga pasojat e ndryshimeve klimatike për të tre aspektet.
- 2 pikë** Nëse përcakton një nga pasojat e ndryshimeve klimatike për dy nga tre aspektet.
- 1 pikë** Nëse përcakton një nga pasojat e ndryshimeve klimatike për një nga tre aspektet.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 31 3 pikë**  
**Model përgjigjeje**

- Rritja e lartësisë së relievit shoqërohet me uljen e temperaturës.
- Rritja e lartësisë së relievit shoqërohet me rritje të sasisë së reshjeve; shtohet intensiteti i vranësirave.
- Ndryshon drejtimi dhe shpejtësia e erës.
- Lartësia dhe copëtimi i madh kushtëzojnë ndryshime të dukshme klimatike ndërmjet zonave apo krahinave.
- Krijohen mikroklima.
- Etj.

- 3 pikë** Nëse evidenton tre nga ndikimet e relievit në klimë.
- 2 pikë** Nëse evidenton dy nga ndikimet e relievit në klimë.
- 1 pikë** Nëse evidenton një nga ndikimet e relievit në klimë.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 32**  
**Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

- Regjistrimi i vitit 2011, evidentoi që për herë të parë në Shqipëri shumica e popullsisë banonte në qytet; Raporti ndryshoi duke evidentuar përqindje më të lartë të popullsisë banuese në qytet kundrejt popullsinë banuese në fshat; Për herë të parë ndryshoi në strukturën e popullsisë sipas vendbanimit raporti i popullsisë urbane me popullsisë rurale në favor të popullsisë urbane.

- 1 pikë** Nëse evidenton saktë ndryshimin që solli në strukturën e popullsisë sipas vendbanimit regjistrimi i vitit 2011.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b) 2 pikë**

- Lëvizja e lirë e popullsisë pas ndryshimeve të vitit 1990;
- mundësi më të mira punësimi në zonat urbane;
- mundësi më të mira arsimimi në zonat urbane;
- ofrimi i shërbimeve më cilësore në zonat urbane;
- mungesa e shërbimeve dhe kushtet jo të përshtatshme për jetesë në zonat rurale;
- Etj.

**2 pikë** Nëse shkruan dy nga faktorët që kanë ndikuar në këtë ndryshim.

**1 pikë** Nëse shkruan një nga faktorët që kanë ndikuar në këtë ndryshim.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 33****Model përgjigjeje****a) 1 pikë**

- Rajoni Jugor ka ndërtim më të thjeshtë gjeologjik ku mbizotërojnë kryesisht gëlqerorët dhe terrigjenët.

**1 pikë** Nëse dallon ndërtimin gjeologjik të këtij rajoni.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**b) 1 pikë**

- Fushëgropa e Delvinës.

**1 pikë** Nëse gjen njësinë fiziko-gjeografike.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

**c) 1 pikë**

- Mbizotëron drejtimi veriperëndim-juglindje.

**1 pikë** Nëse përcakton drejtimin mbizotërues të relievit në këtë rajon.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.